



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI BASHKIAK

Nr 5827 Prot

Gjirokastër më, 05/06/2026

Lënda: Procesverbal i mbledhjes së datës 01.06.2026

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/ 2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe Rregullores së Këshillit Bashkiak po ju vendosim në dispozicion procesverbalin e mbledhjes së datës. 01.06.2026.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më 01.06.2026 në mbledhjen e Këshillit Bashkiak Gjirokastër. Mbledhja po zhvillohet pranë UNED-it. Mbledhja fillon në orën 12:05.

Marrin pjesë në mbledhje 18 anëtarë prezent dhe 1 online (Ana Papadimitri). Mungojnë në mbledhje këshilltarët Rova ,Feruni, Aliko,Qeli, Peta, Mahmutaj,Sufati, Cabeli,Cacaj, Basha.

Hapet mbledhja nga Znj.Isaraj. Është kuorumi për fillimin e mbledhjes.

Znj. Isaraj hap mbledhjen dhe lexon rendin e ditës duke njoftuar këshilltarët se ka dhe disa pika që nuk janë shënuar te rendi i ditës që kanë të bëjnë me :

- P/Vendim " Për miratimin e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar të bllok- ndihmës ekonomike deri në 6% për muajin maj 2026.
- P/Vendim "Për miratimin e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet dhe individët për muajin maj 2026".

Znj.Isaraj hedhim në votim miratimin e kërkesës së Bashkisë Gjirokastër për rendin e ditës që propozova?,

Miratohet me 18 vota pro nga të pranishmit dhe 1 online futja e pikave së mësipërme në rendin e ditës.

Miratohet rendi i ditës me 19 vota pro.

1. Miratimin e procesverbalit të mbledhjes së datës 30.04.2026 ora 12:00.
2. P/Vendim " Për miratimin e sistemeve të pikezimit për programet sociale të strehimit.
3. P/Vendim " Për Përcaktimin e elementëve të pagës bruto për strukturën e Policisë Bashkiake Gjirokastë".

4. P/Vendim " Për planin e masave për parandalimin dhe përballimin e situatave të zjarreve gjatë sezonit të verës në sipërfaqe pyje-kullota nga Drejtoria MZSH-së, Bashkia Gjirokastër,
5. P/Vendim "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar të emergjencës civile për masa parandaluese të rrëshqitjes së shpatit të malit në fshatin "Kolonjë".
6. P/Vendim "Për transferimin e fondeve për projektin "TOUR".
7. P/Vendim " Për miratimin e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar të bllok- ndihmës ekonomike deri në 6% për muajin maj 2026.
8. P/Vendim "Për miratimin e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet dhe individët për muajin maj 2026".
9. Trajtim i kërkesave të qytetarëve.

Hidhet në votë dhe miratohen me 19 vota pro nga të pranishmit dhe 1 online në total 20 vota pro rend i ditës pasi u paraqit në mbledhje dhe Z. Armand Hilaj

- Znj. Isaraj : Kalojmë te pika e parë e rendit të ditës që është :
Miratimin e procesverbalit të mbledhjes së datës 30.04.2026 ora 12:00.

Hidhet në votë dhe miratohen me 19 vota pro nga të pranishmit dhe 1 online në total 20 vota pro procesverbali i mbledhjes së datës 30.04.2026.

- Znj. Isaraj : Kalojmë te pika e II e rendit të ditës që është :
P/Vendim " Për miratimin e sistemeve të pikezimit për programet sociale të strehimit.
Ka kaluar në komisionin përkatës si material.

Hidhet në votë dhe miratohen me 18 vota pro nga të pranishmit dhe 1 online në total 19vota pika e sipercituar.

- Znj. Isaraj : Kalojmë te pika e III e rendit të ditës që është :

P/Vendim " Për përcaktimin e elementëve të pagës bruto për strukturën e Policisë Bashkiake Gjirokastër".

Ka kaluar si material në komisionin përkatës, kush ka pyetje?

Z. Brahim: Pse pikërisht tani pse është e vecantë ka bërë ndonjë shpikje Policia Bashkiake?

Znj. Koko: Pikërisht tani se ka ndryshuar ligji për Policinë Bashkiake dhe udhëzimi përkatës.

Z. Brahim: Kur ka dal ky ligj?

Znj. Koko: Ligji ka dalë në 2023.

Z. Brahim: Dhe kujtohem ne tani në 2026 cka ndryshuar duhet të ketë ndonjë ndryshim cilësor performancë ?

Znj. Koko: Më parë policia është trajtuar njësoj me punonjësit mbështetës. Ligji tani na jep të drejtën që të bëjmë vlerësim dhe përcaktim të elementëve të pagës sipas kuadrit ligjor. Në nenin

9 të ligjit përcaktohet se të gjithë punonjësit mbështetës që nuk trajtohen me ligj të vecantë sic është Ligji për Nëpunësin Civil, këshilli ka të drejtë të përcaktojë elementët përbërës së pagës për cdo lloj kategorie dhe një nga këto kategori është dhe Policia Bashkiake ku ligji për Policinë Bashkiake përcakton që trajtimi financiar për Policinë Bashkiake bëhet nga Këshilli i Bashkisë. Pra jemi përpara faktit që duhet të bëhet vlerësimi i pagave. Deri dhe asnjë nga Policia Bashkiake nuk ka marrë trajtim të vecantë.

Një nga elementët e pagës për Policinë Bashkiake ka kaluar në mbledhjen e muajt prill dhe tani po kalon dhe elementi tjetër që është vjetërsia në punë. Elementët përbërës së pagës bruto të cdo kategorie janë funksioni dhe vjetërsia ndërkohë që Policia Bashkiake ka marrë vetëm funksionin dhe tani dhe vjetërsia .

Znj. Isaraj: Ka më pyetje të tjera jemi të gjithë të qartë e hedhim në votë?

Hidhet në votë dhe miratohen me 19 vota pro nga të pranishmit dhe 1 online në total 20 vota pika e sipërcituar pasi në mbledhje u paraqit dhe këshilltari Erjon Kore.

- Znj. Isaraj : Kalojmë te pika e IV e rendit të ditës që është :

P/Vendim " Për planin e masave për parandalimin dhe përballimin e situatave të zjarreve gjatë sezonit të verës në sipërfaqe pyje-kullota nga Drejtoria MZSH-së, Bashkia Gjirokastrë, Znj.Isaraj : Kush ka pyetje për këtë material?

Z. Brahim: Kam unë një sqarim, unë e lexova materialin dhe nuk ka të shkruar asnjë gjë të shkruar për asnjë lloj bashkëpunimi ndërmjet drejtorisë tuaj dhe Drejtorisë së Pyje Kullotave. Të dyja këto institucione mbajnë përgjegjësi për zjarretse ne shtuam dhe vrojtuesit, për llogari të kujt i shtuam? A ka bashkëpunim ndërmjet jush dhe ndërmarjes së Pyje Kullotave të Bashkisë Gjirokastrë? Vrojtuesit për llogari të kujt u shtuan?

Z. Llapi: Ne kemi një kontratë të përkohshme me vrojtuesit dhe kanë varësi nga drejtoria jonë dhe jo Ndërmarrja e Pyje Kullotave. Sa për bashkëpunimin me Drejtorinë e Pyje Kullotave kemi hartuar një plan masash në mënyrë të detajuar për ndarjen e detyrave që kanë drejtoritë. Është detajuar në planin e masave bashkëpunimi që kemi jo vetëm me Pyje- Kullotat por dhe me Agjencinë e Shërbimeve Utilitare.

Z. Brahim: A ka drejtoria e zjarrëfikëses bashkëpunim me drejtoritë e tjera të qarkut marrëveshje bashkëpunimi se zjarrëfikset i përballojmë ne si bashki ndërkohë që kontributet janë në të gjithë qarkun.

A kanë borxhe këto bashki ndaj nesh, a keni kontratë?

Z. Llapi: Është e përcaktuar me ligj nga ligji i drejtozisë së MZSH për të gjitha stacionet që janë në Qarkun e Gjirokastrës dhe jo vetëm është e përcaktuar që janë të detyruar të marrin pjesë në shuarjen e zjarreve massive. Bashkitë e tjera nuk kanë asnjë detyrim ndaj nesh.

Znj. Isaraj: Ka më pyetje të tjera jemi të gjithë të qartë e hedhim në votë?
Hidhet në votë dhe miratohen me 18 vota pro nga të pranishmit dhe 1 online në total 19 vota pika e sipërcituar.

- Znj. Isaraj : Kalojmë te pika e V e rendit të ditës që është :

P/Vendim “Për përdorimin e fondit të kushtëzuar të emergjencës civile për masa parandaluese të rrëshqitjes së shpatit të malit në fshatin “Kolonjë”.

Z. Brahim: Kam unë dicka, meqëse është emergjenë civile vota ime është pro por në segmentin e rrugës së fshatit Lazarat ka një rrëshqitje dhe situata aty është e rrezikshme. Zyra përkatëse ka ndonjë material për këtë shqetësim që kanë banorët e Fshatit Lazarat?

Znj. Lelaj: Ndërhyrja në atë segment do të bëhet me ndërhyrjen e Drejtorisë së Shërbimeve Publike të bashkisë.

Z.Hila: Kisha dhe unë dicka, rruga hyrëse e Fshatit Asim Zeneli është drejt mbylljes fare dhe përroi po e merr rrugën fare dhe me shirat e parë ajo rrugë do të iki fare.

Znj.Lelaj: Në mbledhjen e kaluar miratuar fondin për bërjen e projektit për këtë rrugë dhe shumë shpejt do të ndërhyet në sistemimin e situatës.

Z. Muho: Bashkia bëri një investim rregulloi urën në hyrje të Fshatit Valare dhe aty Akoma po kalojnë makina të tonazhit të rëndë. Aty duhet të merren masa për të ndaluar qarkullimin e këtyre mjeteve.

Znj. Isaraj: Ka më pyetje të tjera jemi të gjithë të qartë e hedhim në votë?

Hidhet në votë dhe miratohen me 19 vota pro nga të pranishmit dhe 1 online në total 20 vota pika e sipërcituar.

- Znj. Isaraj : Kalojmë te pika e VI e rendit të ditës që është:

P/Vendim “Për transferimin e fondeve për projektin “TOUR”.

Z. Llogo: Si material ka kaluar në komision dhe mendoj se aparati duhet të japi një sqarim për të gjithë këshilltarët.

Znj. Koko: Këto fonde janë miratuar nga ministria dhe do të vinë në buxhetin e bashkisë konform të gjitha procedurave.

- Znj. Isaraj : Kalojmë te pika e VI dhe VIII e rendit të ditës që është:

P/Vendim " Për miratimin e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar të bllok- ndihmës ekonomike deri në 6% për muajin maj 2026.

P/Vendim "Për miratimin e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet dhe individët për muajin maj 2026".

Hidhet në votë dhe miratohen me 19 vota pro nga të pranishmit dhe 1 online në total 20 vota pro.

Z. Drasa: Kisha dicka në lidhje me Drejtorinë e Komunales e cila duhet të jetë më prezente pasi në rrugët e qytetit pasi ka shumë bimësi të papastruar dhe në rrugën e lagjes 11 Janari ka shumë inerte të grumbulluara nga shirat.

Znj. Isaraj , nëse nuk gjë tjetër për të shtuar ju falenderoj dhe e mbyllim këtu këtë mbledhje.

SEKRETAR I KËSHILLIT
Bexhet BAXHELLA



KRTETAR I KËSHILLIT
Merita ISARAJ

